



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 34, datë 17.03.2021

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR.13,
DATË 13.01.2020 “PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN
“KOMPLEKS TURISTIK REZIDENCIAL DHE HOTELIER LURA 5, ISHËM, BASHKIA
DURRËS”**

Në mbështetje të 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Lura” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Harta e Planvendosjes së Strukturave që përmendet në pikën 2, të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.13, datë 13.01.2020 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin “Kompleks turistik rezidencial dhe hotelier Lura 5, Ishëm, Bashkia Durrës”, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

